

VENDIM
Nr. 196, datë 6.3.2013

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 197, DATË 16.3.2011 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR “KFOR”, KOSOVË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 pika 5 e 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 197, datë 16.3.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1, numri “...10 (dhjetë) ...” ndryshohet dhe bëhet “... 9 (nëntë) ...”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kohëzgjatja e këtij misioni, me venddislokim Prishtinë, Kosovë, është deri më 31 dhjetor 2014. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesit e radhës.”.

c) Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Ministria e Mbrojtjes të përballojë për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 4 000 (katër mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shërbim telefonik;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në raste vdekjeje ose sëmundjeje;

ë) akomodim (fjetje, ngrohje, ujë);

f) ushqim;

g) energji elektrike, ujë të pijshëm, lavanderi;

gj) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kryerjes së misionit;

h) çdo shpenzim tjetër për mbarrëvajtjen e kryerjes së operacionit.”.

ç) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, i shtrin efektet nga data 1 mars 2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha